



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 1664/prot  
3

Koplik më: 03/07/2024

V E N D I M

Nr 35, Datë 02 / 07 / 2024

PËR

**DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR(RINOVIM KONTRATE) TË  
SIPERFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË MALËSI E MADHE**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 02.07.2024 bazuar në urdhërin nr.126 datë 07.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira sipas kërkesave , si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika e/1 nenit 64 germa c, ligjin nr.57/2020 “ Për Pyjet ”, VKM nr.888 dt.27.12.2022 “Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve”, Udhëzimi e Ministrisë Të Mjedisit nr.1 , dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në perdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”. VKM nr. 559 dt.29.07.2022 te Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave për dhënien për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” si dhe bazuar në VKM. Nr.433, datë 08.06.2016 , të Këshillit të Ministrave , “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive “, të ndryshuar.

**VENDOSI:**

- I- Dhenien me qira (rinovimin e kontratës nr.4963 datë 06.08.2018 ) të sipërfaqes prej 0.03 ha së Shoqësisë Vodafone ALBANIA SH.A për një afat 10 vjecar.



- II- Siperfaqja prej 0.03 ha të jepet në përdorim (qira) për një afat 10 vjecar me të drejte rinovimi , e cila ndodhet ne ngastrat/nenngastrat 123 të Ekonomisë Pyjore Brojë -1 .
- III- Vlera totale e dhënies me qira ne vit është 300 000(treqindmije) lekë.
- IV- Vlerat dhe treguesit e mësipërm bazohen në raportin e hartuar nga strukura përgjegjëse për pyjet pranë Bashkisë Malësi e Madhe , bashkangjitur këtij projektvendimi.
- V- Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.
- VI- Bashkangjitur gjeni raportin mbi studimin tekniko ekonomik të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve.
- VII- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore“,

KRYETAR  
Ilir Halaj

SEKRETAR  
Emirjan Hasmujaj  
Miratuar me 02.07.2024  
Vota Pro 15  
Vota Kunder 3  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur me datë 03.07.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1664/prot  
/2


Koplik më: 18/6 /2024

PROJEKT -VENDIM

Nr \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024

**PËR**  
**DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR (RINOVIM KONTRATE) TË**  
**SIPERFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË MALËSI E MADHE**

Bazuar ne urdhërin nr.126 datë 07.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira sipas kërkesave , si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika e/1 nenit 64 germa c, ligjin nr.57/2020 “ Për Pyjet ”, VKM nr.888 dt.27.12.2022 “Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve”, Udhëzimi e Ministrit Të Mjedisit nr.1 , dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në perdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”. VKM nr. 559 dt.29.07.2022 te Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave për dhënien për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” si dhe bazuar në VKM. Nr.433, datë 08.06.2016 , të Këshillit të Ministrave , “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive “, të ndryshuar.




## VENDOSI:

Që ti propozojë Këshillit të Bashkisë Malësi Madhe që të miratojë :

- I- Dhenien me qira (rinovimin e kontratës nr.4963 datë 06.08.2018 ) të sipërfaqes prej 0.03 ha së Shoqësisë Vodafone ALBANIA SH.A për një afat 10 vjecar.
- II- Sipërfaqja prej 0.03 ha të jepet në përdorim (qira) për një afat 10 vjecar me të drejte rinovimi , e cila ndodhet ne ngastrat/nenngastrat 123 të Ekonomisë Pyjore Brojë -1 .
- III- Vlera totale e dhënies me qira ne vit është 300 000(treqindmije) lekë.
- IV- Vlerat dhe treguesit e mësipërm bazohen në raportin e hartuar nga struktura përgjegjëse për pyjet pranë Bashkisë Malësi e Madhe , bashkangjitur këtij projektvendimi.
- V- Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.

-----Bashkangjitur gjeni raportin mbi studimin tekniko ekonomik të hartuar nga Drejtoria e -----  
Administrimit të Pyjeve.

Faleminderit për mirëkuptimin!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALESI E MADHE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETVEVE  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1664/Prot.

Koplik ,më: 18/6/2024

Relacion

**PËR**

**MIRATIMIN DHËNIE PËRDORIM FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR(RINOVIM KONTRATE) TË SIPERFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË MALËSI E MADHE**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 64 germa c , nenit 54 germa e/1 propozon:

**Të nderuar këshilltarë**


Bazuar në kërkesen e shoqëria “ Vodafone Albania” sh.a me shkresen ref.prop/018/jk, datë 28.03.2023 ku kërkuar rinovimin e kontratës së qirasë për përdorim të sipërfaqes pyjore per dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullosor për instalim e Stacion Baze Transmetimi (Bts ). Kjo kontratë ka qenë e e lidhur për një afat 5 vjecar.

Më lejoni tu paraqes relacionin për raportin mbi studimin teknik për miratimin e rinovimit të kontratave së qirasë për instalimin të antenës së shoqërisë “vodafone albania” sh.a. të sipërfaqeve pyjore në ekonominë pyjore Broje-1 ,ngastra 123 Njësia Administrative Kelmend,për dhënien në përdorim nga fondi pyjor i sipërfaqes totale 0.03 ha, për një afat 10 (dhjetë) vjeçar.

Nga kjo sipërfaqe nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit , funksionin dhe formen e qeverimit dhe treguesit kryesore të ngastrave të ekonominë pyjore Broje-1.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen VKM nr. VKM nr. 559 dt.29.07.2022 te Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave për dhënien për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr.1.datë 09.06.2016 ”Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

Vlera totale e dhënies me qira ne vit është 300 000 (treqindmije) lekë.




Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen VKM nr.559 datë 29.07.2022.

Bashkangjitur gjeni raportin mbi studimin tekniko-ekonomik.

**Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj.**

KRYETAR  
  
TONIN MARINAJ



Dt. 19.6.2024  
N. Prot. 1664

Bashkia MALESI E MADHE

Shtojca nr. 1

**RAPORT**

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE ME QIRA/NË PËRDORIM TE FONDIT PYJOR KULLOSOR ME OBJEKT RINOVIM KONTRATE QIRAJE TE ANTENES SE SHOQERISE "VADAFONE SHA" SH.A TË SIPËRFAQEVE PYJORE NE EKONOMINE PYJORE BROJE-1, Ngastra 123 NJESIA ADMINISTRATIVE KELMEND NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË MALESI E MADHE**

Bazuar në Urdhrin nr.58 Date 21.6.2024 të Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e komisionit mbi studimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore objekt: **Studimin tekniko ekonomik për rinovim kontrate qiraje te antenës se shoqërisë Vadafone SHA të sipërfaqeve pyjore ne njësinë administrative Kelmend, grupi i punës i përbërë nga specialistet e Drejtorisë Administrimit te pyjeve Z. Qemal Mehja, specialist i Pyjeve Z. Gjovalin Kelaj specialist i Pyjeve, dhe z. Esterin Anaj inspektor i zonës pyjore, nga data 21.6.2024 deri në datën 24.6.2024 studioj kërkesën e subjektit (shoqërisë) VADAFON SHA dhe realizoi verifikimin në terren te dhënat ne regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore.**

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar për t'u saktësuar është **0,03 ha** kjo sipërfaqe jepet ne përdorim per një afat 10 vjeçar.


Nga kjo sipërfaqe nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit dhe jepet ne përdorim sipërfaqja prej **0,03 ha**, e cila shtrihet në ngastrat/në ngastrat 123; te Ekonomisë Pyjore Broje-1 ku është i instaluar stacioni baze i transmetimit (Antena).

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur 1-3).*

Procedurat qe ndiqen për dhënie ne përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë te mbështetura ne VKM Nr. 888, datë 27.12.2022 për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre, në Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

**Vlera totale e dhënies me qira në vit është 300 000 ( Treqind mije) Lekë.**

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit



pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusorë pyjore shtojca 1/7,8.

Shuma në lek/vit konsiston në:

- 1) Vlerën e përdorimit lek/ha/vit 300 000

Trungishte 0,03 \_\_\_\_\_ ha x 10 000 000 Leke = 300 000 Leke

Cungishte \_\_\_\_\_ ha x \_\_\_\_\_ Leke = \_\_\_\_\_ Leke


Shkurre \_\_\_\_\_ ha x \_\_\_\_\_ Leke = \_\_\_\_\_ Leke

Inproduktive etj.. \_\_\_\_\_ ha x \_\_\_\_\_ Leke = \_\_\_\_\_ Leke

Shtojca nr. 2: Ne shtojcën nr.2 ,bashkëngjitur Raportit Teknik dhe pjese e tij janë Tabelat 1-3,

### PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Inxh. Qemal Mehja



Inxh. Arben Precetaj



Insp. Esterin Anaj



KONFIRMOI

KRYETARI I BASHKISE

TONIN MARINAJ

